

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunes)
Nr./Br./No 1193 Nr. i faq./Br. str./No. pg 120
Data/Datum/Date 08 / 09 / 2020
RAHOVEC / ORAHOVAC

KOMUNA RAHOVEC



BULETINI MUJOR KOMUNAL GUSHT 2020

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE	3
PËRFUNDIM	12

HYRJE

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive përgjatë muajve të vitit 2020, rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit në mënyrë të tillë që të mundësojmë që qytetari të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Edhe muaji gusht i vitit 2020, është karakterizuar me një sërë aktiviteteve, pas shfaqjes së pandemisë COVID-19, situatë kjo e cila ka sjellur mjaft vështirësi edhe në Komunën e Rahovecit.

Me anë të këtij buletini mujor për muajin gusht ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet nga ana e Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive në Komunën e Rahovecit.

AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE



Në vazhdim të avancimit të bashkëpunimit ndërmjet nivelit qendror dhe lokal, Kryetari Smajl Latifi ka pritur në takim Ministrin e MZHR-së, z. Enis Kervan. Gjatë takimit ata diskutuan mbi idetë dhe mundësitë për realizimin e projekteve mbi situatën e krijuar nga pandemia Covid-19 si dhe projektet me periudhë kohore afatgjatë që mund të realizohen në mes komunës së Rahovecit dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

I shoqëruar nga drejtori i Bujqësisë dhe drejtori i Ekonomisë, Kryetari Latifi ka vizituar fabrikën për përpunimin dhe konservimin e perimeve "APETITI" në Krushë të Madhe dhe Qendrën Grumbulluese të pemëve dhe perimeve "Agro Celina" në Xërxe. Ai ka uruar të dy pronarët dhe menaxhmentin e NPT "APETITI" dhe QG "Agro Celina" për rezultatet e arritura deri më tani. I siguroi se në të ardhmen bashkëpunimi në mes të komunës dhe bizneseve, që janë storie suksesi do të jetë edhe më i madh dhe në këtë pikë mbështetja nga komuna e Rahovecit nuk do të mungojë asnjëherë.



Kryetari Smajl Latifi bashkë me Nënkryetarin Fatmir Iska kanë pranuar një donacion prej 5000 maskash, nga një mërgimtar i cili ka preferuar që të mbetet anonim, por ka vendosur që donacionin ta dorëzojë nëpërmjet Nazim Vuçitërrnës. Pas pranimi të donacionit, një pjesë të maskave, Komuna e Rahovecit i ka dhuruar për Stacionin Policor Rahovec (2000 copë), QKMF-në dhe Administratën Komunale Rahovec (2000 copë) dhe për Bashkësitë Fetare (1000 copë).



Ardian Thaçi nga fshati Çifllak, ka dhuruar 5000 maska sosh për komunën e Rahovecit, maska këto të cilat do të shërbejnë për përdorim të nevojave të komunës sonë, në funksion të mbrojtjes së shëndetit publik. Kryetari Latifi e ka falënderuar Ardianin për ndihmën e dhënë dhe solidarizimin në kohë pandemie.

Në fshatin Malësi e Vogël, Kryetari Smajl Latifi së bashku me familjarë, bashkëluftëtarë dhe bashkëpunëtorë, në 22 vjetorin e rënies në krye të detyrës, nderuan kujtimin e luftëtarit të UÇK-së, Skender Kastrati.

Emri dhe vepra e dëshmorit Skender Kastrati është skalitur në kujtesën tonë dhe do të jetojë ndër breza.

Lavdi!



Është nënshkruar kontrata për ndërtimin e serrave të përmasave: 3, 5, 7 dhe 10 ari. Kjo kontratë, që kap vlerën e 670,631.95 eurove, tregon përkushtimin tonë në përkrahjen e bujqësisë duke investuar në fusha që janë me interes për bujqit. Me kontratën që është lidhur, do të ndërtohen serra në sipërfaqe 9.7ha në komunën tonë, e kontrata është e ndarë në dy lote në vlerë prej: LOT I - 388,463.70€ dhe LOT II- 282,168.25€.

Kryetari Smajl Latifi ka pritur në takim ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë z. Armend Zemaj, ku bashkëbiseduan rreth menaxhimit të pandemisë COVID-19 dhe për pikat e vazhdimet të bashkëpunimit ndërinstitutional që t'ju dalin sa më shumë në ndihmë qytetarëve të komunës së Rahovecit. Bashkë me ministrin Zemaj diskutuan edhe për kapacitetet që ka Komuna e Rahovecit për të menaxhuar situatën me Covid-19 në ditët e ardhshme.






Në fshatin Bërtatin të komunës së Rahovecit, tashmë është bërë traditë që prodhimi i silazhit të misrit të bëhet në mënyrë të organizuar nga të gjithë fermerët e kësaj ane, gjë që ky proces të përfundojë në kohën më të mirë. Për të parë nga afër punën e vyeshme të fermerëve, Kryetari Latifi ka vizituar disa nga auto kombanjerët, duke ju uruar punë të mbarë dhe të bereqetshme për këtë vit.

Kryetari Smajl Latifi ka zhvilluar një takim me përfaqësues të fermerëve të dëmtuar nga breshri dhe vërshimet që ndodhën gjatë muajit maj në komunën tonë. Arsyeja që ata ja kishin mësyre komunës së Rahovecit, ishte për të shprehur pakënaqësinë e tyre ndaj vonesave të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Bujqësisë, në ekzekutimin e 25% të vlerës së dëmit të shkaktuar nga breshri dhe vërshimet.




Instituti GAP ka publikuar në platformën elektronike "Letërnjoftimi i Komunave" të dhënat më të fundit për realizimin e premtimeve të dhëna gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2017. Periudha e monitorimit përfshin gjashtëmuajorin e parë të 2020. Në bazë të rezultateve të dalë nga vlerësimi i përbushjes së premtimeve, Komuna e Rahovecit ka treguar një performancë mjaft të mirë, dhe shumë të kënaqshme në përbushjen e planeve dhe projekteve të parapara, ku nga gjithsej 24 premtime, niveli i përbushjes është ky si në vijim:

- ➡ 14 PREMTIME TË PËRFUNDUARA;
- ➡ 6 PREMTIME GJYSMË TË PËRMBUSHURA;
- ➡ 4 PREMTIME TË FILLUARA.



Kërkesë e kahmotshme dhe e domosdoshme e bujqve të cilët me vite të tëra janë përballur me vështirësitë e lëvizjes dhe punës së tokave (arave) të tyre, ka qenë rregullimi i rrugëve fushore, e që fermerëve do t'ju mundësonte qasje më të lehtë për kryerjen e punëve agroteknike. Andaj, edhe ne si komunë duke marrë parasysh këto kërkesa, kemi filluar punimet për rregullimin e rrugëve fushore në fshatin Xërxe.

Drejtori i Bujqësisë z. Berat Duraku së bashku me Nënkrjetarin e Komunës së Rahovecit z. Fatmir Iska, kanë vizituar disa nga vreshtarët të cilët kanë filluar vjeljen e disa varieteteve të hershme të rrushit. Edhe përkundër faktit që këtë vit fermerët janë ballafaquar me problemet e shumta si pasojë e virusit COVID-19, puna e tyre primare nuk është ndalur aspak.



Në zonat fushore në fshatin Celinë të Komunës së Rahovecit po hapen rrugët fushore ku shumica prej tyre janë mbyllur pothuajse 20 vite më parë, duke ju pamundësuar fermerëve kryerjen e punëve në tokat e tyre bujqësore. Projekti për rregullimin e rrugëve fushore është planifikuar që infrastruktura fushore të prekë secilin vendbanim në komunën tonë.

Pas takimit me Kryetarin e Komunës Smajl Latifi, përfaqësuesit e fermerëve të dëmtuar nga breshëri dhe vërshimet së bashku me Drejtorin e Bujqësisë z. Berat Duraku janë pritur në takim nga U.D i Sekretarit të Përgjithshëm në MBPZHR, z. Bekim Hoxha. Gjatë këtij takimi Drejtori Duraku ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm për vonesën e krijuar për mos realizmin e pagesave për dëmet e krijuara si pasojë e fatkeqësive natyrore.





Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, sërisht pasurohet me tituj të rinj librash! Në kuadër të konkursit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është aprovuar kërkesa jonë për pasurimin e bibliotekës, ku dhe jemi fitues të grantit në vlerë prej 1,000 euro. Në bazë të kërkesave të lexuesve tanë, kemi bërë përzgjedhjen e titujve të kërkuar, të cilët do të jenë në dispozicion të lexuesve.

Drejtoresha e DKRS-së Bjondina Kleqka, bashkë me ekipin punues, vizituan disa nga asetet e trashëgimisë kulturore-historike, të cilat do të nënshtrohen intervenimeve konservuese dhe restauruese, ku një pjesë e tyre janë në proces të punimeve.



Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur mbledhjen e tetë të rregullt për vitin 2020. Pas diskutimeve nga anëtarët e KPF-së dhe prezantimit të drejtoreshës për Kulturë, Rini dhe Sport, është rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit Komunal edhe propozimi i vendimit të Kryetarit të Komunës për emërtimin e Muzeut të Qytetit, me emrin e personalitetit të shquar të çështjes kombëtare dhe veteranit të arsimit "Ali (Bajram) Hasku".



Kryetari Smajl Latifi, së bashku me stafin e tij kanë pritur për vizitë profesorin e koreografisë Dilaver Kryeziu, Mehmed Xhemajlin profesor i Historisë së Vallëzimit Shqiptar dhe Feim Lekën, student i Koreografisë dhe njëri ndër valltarët më të dalluar të Ansambllit Shtetëror Shota. Ata diskutuan për mundësitë e ndryshme për bashkëpunim lidhur me organizimin e aktiviteteve të ndryshme, sidomos për mundësinë dhe formën e mbajtjes së festivalit tashmë tradicional në komunën tonë, festivalin "Anadriina Jehon", gjithmonë duke respektuar masat dhe vendimet e qeverisë lidhur me pandeminë.



Në mbledhjen e tetë të rregullt të Kuvendit Komunal të Rahovecit, është aprovuar propozimi i vendimit të Kryetarit të Komunës për emërtimin e Muzeut të Qytetit "Ali Hasku".

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport ka nënshkruar kontratat me shumicën prej përfitueve të subvencioneve për vitin 2020. Mbi këtë bazë janë mbështetur financiarisht nëntëmbëdhjetë OJQ sportive dhe një subjekt individual, trembëdhjetë OJQ kanë përfituar mbështetje me projekte kulturore e rinore, si dhe tetë projekte individuale. Shuma e përgjithshme e ndarë për Kulturë, Rini dhe për projekte individuale arrin vlerën e 31 mijë eurove, sporti ka përfituar gjithsej 64 mijë euro, duke arritur kështu shumën e përgjithshme prej 95 mijë euro.



Pas përfundimit të instalimit të ngrohjes qendrore në shkollën fillore të Pataqanit të Poshtëm, po vazhdojnë punët në instalimin e ngrohjes në paralelen e ndarë të shkollës "Vëllezërit Frashëri" në Senoc. Punimet po shkojnë mirë dhe brenda disa ditëve pritet finalizimi edhe i këtij projekti shumë të rëndësishëm.

Drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim vizitoi disa nga shkollat e mesme të larta, ku për të tretën ditë me radhë po vazhdon regjistrimi i nxënësve në klasën e dhjetë. Komisionet e pranimi të emëruara nëpër shkolla po presin nxënësit, të cilët po aplikojnë në drejtimet e tyre të preferuara. Gjatë procesit të regjistrimit janë marrë masa mbrojtëse ndaj pandemisë dhe nxënësit aplikues në konkurs janë të obliguar të mbajnë distancën dhe të mbajnë maska mbrojtëse.





Në objektin e shkollës "Gëzim Hamza-Piktori" po vazhdon puna në riparimin e dyshemeve të klasave dhe nyjeve sanitare! Dyshemetë e klasave tani po shtrohen me shtresër e linoleumit.

Në 5 objektet shkollore në të cilat është mbajtur Testi i Maturës, u bë dezinfektimi. DKA ka falënderuar për zemërsisht ekipin dezinfektues të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe drejtorin e saj z.Samir Mustafa për angazhimin maksimal dhe ndihmën e dhënë DKA-së.



Kanë filluar punimet në ndërtimin e dy segmenteve rrugore në fshatin Drenoc.



Kompanitë e kontraktuara të komunës së Rahovecit, duke bërë mirëmbajtjen e hapësirave publike.




Vazhdojnë punimet në rregullimin e infrastruktures publike!
Pjesa e punimeve në rrugë, gjatë trajtimit të lëshesave ujore në segmentin e rrugës Sapniq-Nashpall!

Kompleksi i Dëshmorëve në Gradish!



CENTRAL CITY SQUARE
RAHOVEC

Citizens vision for the Central City Square
What is your vision for the Central City Square?



Mbi 1300 qytetarë të Rahovecit janë angazhuar për të kontribuar në krijimin e vizionit për Sheshin Qendror të Qytetit. Zëri i tyre është dëgjuar përmes përgjigjeve të shumta në pyetësor. Qytetarët kanë treguar se duan një hapësirë publike të dizajnuar mirë me parqe dhe vende për rekreacion. Shikoni grafikun me të gjeturat nga përgjigjet e qytetarëve për vizionin e Sheshit Qendror të Qytetit.



Ndërtimi i rrugës në fshatin Zaqisht, i cili është projekt në bashkëfinancim i Komunës së Rahovecit dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal me vlerë prej 47.813, 17€.



Drejtori i DEZHT-së, Arçan Asllani bashkë me zyrtaren për turizëm znj.Saranda Shala i bëri vizitë Verarisë Familjare “Labi Wine” me pronar Labinot Shulina. DEZHT do të mundohet me çdo kusht që ta përkrahë dhe të bashkepunojë me të, në mënyrë që ai të fuqizohet dhe të ketë shumë suksese në të ardhmen në zhvillimin e turizmit të verës.

PËRFUNDIM

Ky buletin përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe:

(gusht 2020).

Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Rahovec, gusht 2020